



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**

---

Prishtinë, 06 Maj, 2022

**THIRRJA PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PROFESIONALE TË PROFESIONISTËVE  
TË RINJ NËPËRMJET MBËSHTETJES FINANCIARE STUDIMORE NË FUSHËN E  
KULTURËS, TRASHËGIMISË KULTURORE DHE SPORTIT  
PËR VITIN 2022**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) renditë për vitin 2022 ndër prioritet programore ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimin e kuadrove në fushat të kulturës, trashëgimisë kulturore dhe sportit. Theks të veçantë ka edukimin artistik të të rinjve, mbështetjen e hulumtimeve, kërkimeve dhe prezentimeve në fushën e trashëgimisë kulturore, dhe edukimin profesional në fushën e menaxhimit dhe mjekësisë sportive.

Të drejtë aplikimi në thirrjen publike për mbështetje financiare studimore kanë individët që dëshmojnë se programi studimor është i profilizuar në fushat specifike të kulturës, trashëgimisë kulturore dhe sportit siç janë të elaboruara më poshtë në kategoritë e thirrjes. Individët mund të aplikojnë në njërin nga kategoritë në vijim:

- 1. Mbështetje financiare për studime në fushën e kulturës,**
- 2. Mbështetje financiare për studime në fushën e trashëgimisë kulturore,**
- 3. Mbështetje financiare për studime në sport.**

Prioritet për mbështetje do të kenë programet e specializuara në Master dhe Doktoraturë, por do të mbështeten edhe programet Bachelor.

Tre kategoritë e listuara më sipër janë të elaboruara në vijim duke zbërthyer synimet, profilet, kriteret e përgjithshme, periudhën e mbështetjes, si dhe shkallën maksimale të mbështetjes.

## **Vlerësimi i aplikimeve:**

Vlerësimi administrativ, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

Vlerësimi përmbajtësor, që vlerëson:

- Nëse aplikuesi është student i fushës së kulturës, trashëgimisë kulturore ose sportit;
- Nëse aplikimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrjeje publike;
- Nëse aplikimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- Nëse kostot e aplikimit janë përbrenda shumave të përcaktuara me këtë thirrje.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

## **Dokumentet e nevojshme të aplikimit**

Dokumentet e nevojshme të aplikimit duhet të jenë të radhitura saktësisht sipas kërkesës. Nuk ka nevojë të bashkangjiten dokumente shtesë të cilat nuk kërkohen me ftesë. Aplikimeve të cilave iu mungon ndonjë dokument nga kjo listë, do të eliminohen nga shqyrtimi i mëtejshëm i dosjes.

Aplikimi i individëve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrje publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formularin e aplikimit (të plotësuar dhe nënshkruar);
2. Formularin e deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (të plotësuar dhe nënshkruar);
3. Formularin e propozim buxhetit (të plotësuar dhe nënshkruar);
4. Kopjen e letërnjoftimit ose pasaportës së Republikës së Kosovës;
5. Konfirmimin mbi llogarinë bankare të lëshuar nga banka përkatëse;
6. CV-në, në njërën prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës;
7. Kopjen e noterizuar të diplomës së shkollës së mesme, kopjen e noterizuar të vendimit për nostrifikimin e diplomës (nëse është diplomë e huaj), si dhe përkthimin zyrtar të diplomës nëse nuk është në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës (vetëm për studentët e regjistruar në nivelin Bachelor);
8. Kopjen e noterizuar të diplomës së studimeve themelore, kopjen e noterizuar të vendimit për nostrifikimin e diplomës (nëse është diplomë e huaj), si dhe përkthimin zyrtar të

diplomës nëse nuk është në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës (vetëm për studentët e regjistruar në nivelin Master);

9. Kopjen e noterizuar të diplomës së nivelit Master, kopjen e noterizuar të vendimit për nostrifikimin e diplomës (nëse është diplomë e huaj), si dhe përkthimin zyrtar të saj nëse nuk është në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës (vetëm për studentët e regjistruar në nivelin e Doktoratës);
10. Dëshmi për pranimin/regjistrimin në programin studimor të lëshuar nga fakulteti përkatës, të nënshkruar, vulosur, dhe të përkthyer nga zyrtarë të autorizuar, në njërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës (vetëm për studentët që janë pranuar në vitin e parë të studimeve në fakulteti përkatës);
11. Dëshmi për vijueshmërinë e studimeve në programin studimor të lëshuar nga fakulteti përkatës, të nënshkruar, vulosur, dhe të përkthyer nga zyrtarë të autorizuar, në njërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës (vetëm për studentët që tanimë vijnë në studimet në fakultetin përkatës);
12. Transkriptin e notave të vitit/eve paraqite të programit studimor për të cilin individ po aplikon për financim, të nënshkruar, vulosur, dhe të përkthyer nga zyrtarë të autorizuar, në njërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës (vetëm për studentët që tanimë vijnë në studimet në fakultetin përkatës, nëse aplikohet);
13. Programin e studimeve të lëshuar nga fakulteti përkatës, të nënshkruar, të vulosur dhe të përkthyer nga zyrtarë të autorizuar, në njërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës;
14. Raportin narrativ / financiar në lidhje me mbështetjen financiare paraqite nga fondet publike të RKS (vetëm për studentët të cilët kanë fituar mbështetje financiare studimore për të njëjtin program të studimeve për vitin/et paraqite);
15. Konfirmimin nga ofruesi i mbështetjes financiare paraqite nga fondet publike të RKS, të nënshkruar dhe të vulosur, në lidhje me kryerjen e të gjitha detyrimeve kontraktuale nga përfituesi (vetëm për studentët të cilët kanë fituar mbështetje financiare studimore për të njëjtin program të studimeve për vitin/et paraqite);
16. CD ose USB me të gjitha dokumentet e kërkuara nga lista në trajtë PDF.

### **Shuma totale:**

Vlera totale e planifikuar e thirrje për mbështetje financiare studimore është 300,000.00 Euro.

### **Afati për aplikim:**

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm aplikimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për aplikim është data 17 Qershor 2022.

## **Më shumë informacione rreth thirrje publike:**

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike për mbështetjen financiare studimore mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [jehona.shyti@rks-gov.net](mailto:jehona.shyti@rks-gov.net); [vjollca.aliu@rks-gov.net](mailto:vjollca.aliu@rks-gov.net); [fikret.shatri@rks-gov.net](mailto:fikret.shatri@rks-gov.net).

### **KATEGORIA E PARË:**

#### **Mbështetje financiare studimore në fushën e kulturës**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka për synim edukimin artistik të të rinjve dhe zhvillimin e kuadrove profesionale me fokus në profilet kulturore. Ky konsolidim kualitativ dhe përmbajtësor i kuadrove që ndërlidhen me kulturën parashihet të adresohet nëpërmjet mbështetjes financiare për individët të cilët fokusojnë studimet e tyre në profilet dhe fushat në kulturë të listuara si më poshtë.

Drejtimet apo programet specifike, studimet e të cilave do të mbështeten financiarisht në fushën e kulturës janë:

1. Menaxhim i artit / Menaxhim kulturor;
2. Histori e Artit;
3. Kritikë e Artit;
4. Studime bibliotekare / Arkivim;
5. Koreografi;
6. Mjeshtër ndriçues për teatër ose/dhe film;
7. Mjeshtër i zërit për teatër ose/dhe film;
8. Kurator/e për galeri;
9. Restaurim i veprave të artit.

#### **Kush mund të aplikojë:**

- Studentët;
- Profesionistët e rinj në fushën e kulturës;
- Profesionistët në fushën e kulturës;

Të gjithë këta individë duhet të kenë dëshminë e regjistrimit në njërin nga programet e lartpërmendura dhe të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale.

#### **Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

- të kenë kryer të gjitha detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit (nëse aplikuesi ka fituar bursë studimore për të njëjtin program të studimeve për ndonjë vit paraprak);
- të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për programin e njëjtë studimor për të njëjtin vit të studimeve e cila tejkalon shumën e shpenzimeve që kërkon programi;
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës (aplikuesi nuk mund të jetë i punësuar në MKRS ose institucionet vartëse të saj);
- të jetë i/e pranuar/regjistruar në programin studimor për Bachelor, Master ose Doktoratë brenda apo jashtë vendit, në ndonjërin prej profileve të Kulturës të lartcekura,
- të ketë dëshmi të suksesit të studimeve nga viti paraprak akademik me notë mesatare mbi 8.5, (nëse student tanimë është duke vijuar studimet),
- të ketë dëshmi të suksesit të shkollimit me notën "shkëlqyeshëm" nga shkolla e mesme (vetëm për studentët e vitit të parë Bachelor),
- t'i ketë përfunduar obligimet paraprake të programit të studimeve për të cilin aplikon për financim (nëse studenti tanimë është duke vijuar studimet).

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

#### **Periudha e mbështetjes me mbështetje financiare studimore:**

Mbështetja financiare studimore do të vlejë deri në përfundim të vitit akademik 2022/2023.

#### **Shkalla e mbështetjes:**

- |   |                 |
|---|-----------------|
| • Shkalla e mbështetjes (%)                             | 100%.           |
| • Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit         | 10,000.00 Euro  |
| • Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit          | N/A Euro        |
| • Vlera maksimale totale e mbështetjes për kategorinë 1 | 100,000.00 Euro |

#### **KATEGORIA E DYTË:**

#### **Mbështetje financiare studimore në fushën e trashëgimisë kulturore**

Synim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është mbështetja e hulumtimeve, kërkimeve dhe prezentimeve në fushën e trashëgimisë kulturore me fokus në profilet deficitare. Edhe ky synim parashihet të adresohet nëpërmjet mbështetjes financiare për individët të cilët fokusojnë studimet e tyre rreth fushave dhe profileve në trashëgiminë kulturore të listuara si mëposhtë.

Drejtimet apo programet specifike, studimet e të cilave do të mbështeten financiarisht në fushën e trashëgimisë kulturore janë:

1. Arkitekturë – Konservim/Restaurim;

2. Planifikim hapësinor / Konservim i integruar;
3. Shkenca të Arkeologjisë;
4. Antropologji (fizike, biologjike, kulturore, dhe linguistike);
5. Histori e arkitekturës / Histori e artit;
6. Muzeologji (menaxhim i muzeve, programe kuratoriale, menaxhim i ekspozitave, hulumtim);
7. Konservim dhe restaurim i artefakteve (gur, dru, metal, tekstil, qeramikë etj.)

**Kush mund të aplikojë:**

- Studentët;
- Profesionistët e rinj në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Profesionistët në fushën e trashëgimisë kulturore;

Të gjithë këta individë duhet të kenë dëshminë e regjistrimit në njërin nga programet e lartpërmendura, dhe të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale.

**Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- të kenë kryer të gjitha detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit (nëse aplikuesi ka fituar bursë studimore për të njejtin program të studimeve për ndonjë vit paraprak);
- të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për programin e njejtë studimor për të njejtin vit të studimeve e cila tejkalon shumë e shpenzimeve që kërkon programi;
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës (aplikuesi nuk mund të jetë i punësuar në MKRS ose institucionet vartëse të saj);
- të jetë i/e pranuar/regjistruar në programin studimor për Bachelor, Master ose Doktoratë brenda apo jashtë vendit, në ndonjërin prej profileve të trashëgimisë kulturore të lartcekura,
- të ketë dëshmi të suksesit të studimeve nga viti paraprak akademik me notë mesatare mbi 8.5, (nëse student tanimë është duke vijuar studimet),
- të ketë dëshmi të suksesit të shkollimit me notën "Shkëlqyeshëm" nga shkolla e mesme (vetëm për studentët e vitit të parë Bachelor),
- T'i ketë përfunduar obligimet paraprake të programit të studimeve për të cilin aplikon për financim (nëse student tanimë është duke vijuar studimet).

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

**Periudha e mbështetjes me mbështetje financiare studimore:**

Mbështetja financiare studimore do të vlejë deri në përfundim të vitit akademik 2022/2023.

### Shkalla e mbështetjes:

- Shkalla e mbështetjes (%) 100%.
- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit 10,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit N/A Euro
- Vlera maksimale totale e mbështetjes për kategorinë 2 100,000.00 Euro

### KATEGORIA E TRETË:

#### Mbështetje financiare studimore në fushën e sportit

Në fushën e sportit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka për synim ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe kuadrove me njohuri profesionale për menaxhimin dhe administrimin sportiv dhe mjekësinë sportive.

Ngritja e kuadrove profesionale në sektorin e sportit parashihet të adresohet nëpërmjet mbështetjes financiare për individët të cilët fokusojnë studimet e tyre në fushat dhe profilet e Sportit të listuara si mëposhtë.

Drejtimit apo programet specifike, studimet e të cilave do të mbështeten financiarisht në fushën e Sportit janë:

1. Administrim/Menaxhim Sportiv;
2. Mjekësi Sportive;
3. Shkenca Sportive;
4. Biznes/Industri Sportive;
5. Gazetari Sportive;
6. Trajner Sportiv;
7. Menaxhim i ngjarjeve sportive;
8. Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti.

#### Kush mund të aplikojë:

- Studentët;
- Profesionistët e rinj në fushën e sportit;
- Profesionistët në fushën e sportit;

Të gjithë këta individë duhet të kenë dëshminë e regjistrimit në njërin nga programet e lartpërmendura, dhe të plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

## Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- të kenë kryer të gjitha detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit (nëse aplikuesi ka fituar bursë studimore për të njejtin program të studimeve për ndonjë vit paraprak);
- të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për programin e njejtë studimor për të njejtin vit të studimeve e cila tejkalon shumën e shpenzimeve që kërkon programi;
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës (aplikuesi nuk mund të jetë i punësuar në MKRS ose institucionet vartëse të saj);
- të jetë i/e pranuar/regjistruar në programin studimor për Bachelor, Master ose Doktoratë brenda apo jashtë vendit, në ndonjërin prej profileve të Sportit të lartcekura,
- të ketë dëshmi të suksesit të studimeve nga viti paraprak akademik me notë mesatare mbi 8.5, (nëse student tanimë është duke vijuar studimet),
- të ketë dëshmi të suksesit të shkollimit me notën "Shkëlqyeshëm" nga shkolla e mesme (vetëm për studentët e vitit të parë Bachelor),
- t'i ketë përfunduar obligimet paraprake të programit të studimeve për të cilin aplikon për financim (nëse student tanimë është duke vijuar studimet).

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

## Periodha e mbështetjes me mbështetje financiare studimore:

Mbështetja financiare studimore do të vlejë deri në përfundim të vitit akademik 2022/2023.

## Shkalla e mbështetjes:

- |   |                 |
|---|-----------------|
| • Shkalla e mbështetjes (%)                             | 100%.           |
| • Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit         | 10,000.00 Euro  |
| • Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit          | N/A Euro        |
| • Vlera maksimale totale e mbështetjes për kategorinë 3 | 100,000.00 Euro |

### 1. MËNYRA E APLIKIMIT:

Aplikacionet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë të cilët janë pjesë përbërëse e kësaj fteseje publike.

Dokumentet e kompletuara brenda zarfit të formatit A4, duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në trajtë fizike, në adresën e mëposhtme:



*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*

*Sheshi Nëna Terezë; Zyra e Arkivës, Nr. 22; 10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës*

Titulli që duhet shënuar në pjesën e jashtme të zarfit:

***APLIKIM PËR THIRRJEN PUBLIKE PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PROFESIONALE TË PROFESIONISTËVE TË RINJ NËPËRMJET MBËSHTETJES FINANCIARE STUDIMORE NË FUSHËN E KULTURËS, TRASHËGIMISË KULTURORE DHE SPORTIT PËR VITIN 2022***

***Emri, mbiemri dhe adresa e aplikantit.***

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm aplikimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë ftesë publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

Kërkesa konsiderohet se është dorëzuar brenda periudhës së ftesës nëse vula pranuese tregon se është marrë në postë deri në fund të datës së ftesës, si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në zyrë, aplikantit do t'i lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [jehona.shyti@rks-gov.net](mailto:jehona.shyti@rks-gov.net); [vjollca.aliu@rks-gov.net](mailto:vjollca.aliu@rks-gov.net) dhe [fikret.shatri@rks-gov.net](mailto:fikret.shatri@rks-gov.net) , jo më vonë se pesë ditë para mbylljes së ftesës publike.

## 2. DOKUMENTACIONI SHITESË DHE KONTRAKTIMI

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të komisionit, MKRS-ja mund të kërkojë dokumentacion shtesë nga aplikantët e përzgjedhur dhe mund të kërkojë shqyrtimin e vijave buxhetore për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Nëse përfituesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar (jo më shumë se 10 ditë), përfituesi do të refuzohet.

## 3. KALENDARI I REALIZIMIT TË FTESËS PUBLIKE

Fazat e procedurës së thirrjes

1. Afati i fundit për aplikimet: **17 Qershor 2022**

2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen: **5 ditë para mbylljes së Ftesës për Aplikim**
3. Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi aplikantëve: **1 muaj pas përfundimit të Ftesës Publike**

#### 4. LISTA E DOKUMENTEVE TË FTESËS PUBLIKE

##### **Formularët që i gjeni brenda ftesës publike:**

1. *F9. Formulari i aplikacionit*
2. *F10. Formulari i propozim-buxhetit*
3. *F11. Formulari mbi financimin e dyfishtë*
4. *F13. Formulari mbi financimin nga burimet publike të financimit*